



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4581/4 /Prot.

Tiranë, më 12.10. /10 /2024

URDHËR

Nr. 537 datë 18 / 10 2024

**“PER ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TE KUALIFIKIMIT TE ADMINISTRATOREVE
TE FALIMENTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001" Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të ligjit nr.110, datë 27.10.2016 "Për falimentimin", të pikës 14 të VKM-së nr. 542, date 19.9.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit" si dhe nenit 9 të VKM-së nr. 294, datë 17.5.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave, për paraqitjen e kërkesave, për të vepruar si administrator në procedurat e falimentimit, si dhe procedurën për dhënien e heqjen e licencës",

URDHËROJ:

1. Provimi i kualifikimit për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të Administratorit të Falimentimit, të zhvillohet në datën 02/12/2024, në orën 10:00 në Ministrinë e Drejtësisë;
Kandidatët e interesuar, të dorëzojnë elektronikisht kërkesën për shprehje interesi dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin qeveritar "e-Albania", brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit të Thirrjes për Shprehje Interesi, sipas përcaktimeve në VKM nr. 294, datë 17.5.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave, për paraqitjen e kërkesave, për të vepruar si administrator në procedurat e falimentimit, si dhe procedurën për dhënien e heqjen e licencës";
2. Tarifa për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit të jetë sipas përcaktimit në nenin 9, pika 2, të VKM-së nr nr. 294, datë 17.5.2023 dhe të paguhet në lekë në shumën 10 000 (dhjetëmijë), në llogarinë bankare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, në llogarinë ekonomike 7111099;
3. Struktura përgjegjëse për licencimin e administratorëve, pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, administron shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit, brenda afatit të përcaktuar në nenin 6, pika a) dhe b), e VKM-së nr. 294, datë 17.05.2023;

4. Struktura përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi për vazhdimin e procedurës së verifikimit ose përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret për të vepruar si administrator, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative;
5. Në përfundim të verifikimit për plotësimin e kriterëve për të vepruar si administrator, struktura përgjegjëse harton relacionin shpjegues për secilin kandidat, ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, si dhe njoftimin përkatës;
6. Kandidatet, të cilëve u është refuzuar kërkesa, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Ministrin të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve ligjore;
7. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kriterëve për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit ose skualifikimin përfundimtar të tij nga pjesëmarrja në provim. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit;
8. Rregullat për organizimin dhe zhvillimin e provimit përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 17.5.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave, për paraqitjen e kërkesave, për të vepruar si administrator në procedurat e falimentimit, si dhe procedurën për dhënien e heqjen e licencës";
9. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe Ministrisë së Drejtësisë, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga përfundimi i afatit të publikimit të thirrjes për shprehje interesi;
10. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Falimentimit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhri;
11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit, për njoftimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

